Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

PLANI VJETOR I AUDITIMIT

(për sezonin auditues - 2026/2027)



Prishtinë, tetor 2026


TABELA E PËRMBAJTJES

1.FJALOR I SHPREHJEVE 3
2.VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT 4
3.HYRJE.....6
4.AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE 7
5.OBJEKTIVAT E PLANIT VJETOR TË AUDITIMIT 13
6.BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE..... 24
7.ZBATIMI I PLANIT VJETOR 25
Shtojca 1. Subjektet/temat dhe shuma e buxhetit që do të auditohet. 26

1. FJALOR I SHPREHJEVE

ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
AP	Auditori i Përgjithshëm
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit
PVA	Plani Vjetor i Auditimit
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
RFV/BK	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
PFV	Pasqyrat Financiare Vjetore
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
SITA	Sistemi Informativ i Teknologjisë së Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA)
KMFP	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
NP	Ndërmarrje Publike
OJQ	Organizata Joqeveritare
OB	Organizata Buxhetore
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
DEMOS	Programi për Decentralizim dhe mbështetje komunale
KOSTT	Korporata e transmisionit, sistemit dhe tregut të energjisë elektrike
SH.A	Shoqëri Aksionare
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MMPHI	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
MD	Ministria e Drejtësisë
NPH	Ndërmarrja Publike Hidro-ekonomike
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

2. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT



VIZIONI

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model, që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.



MISIONI

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe rritjen e l logaridhënies publike.



VLERAT E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione t ë besueshme dhe të paanshme.

Profesionalizmi

ZKA-ja udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të ONISA-së dhe nga praktikat më të mira ndërkombëtare.

Integriteti

ZKA-ja angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.

Transparenca

ZKA-ja është organizatë e hapur dhe do t'i bëjë publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofrojë publikut të gjerë informacionin e përfituar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA-ja angazhohet që të promovojë transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

Fryma ekipore

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunuese në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

3. HYRJE

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), si Institucion Suprem i Auditimit (ISA), kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm (AP) përcaktohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

ZKA-ja kryen auditimin e pasqyrave financiare vjetore të të gjitha organizatave buxhetore, me qëllim të vlerësimit nëse ato paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare, si dhe nëse fondet publike menaxhohen dhe shpenzohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe qëllimet e miratuara. Përveç këtyre auditimeve, ZKA-ja kryen auditime të ndërmarrjeve publike, auditime të pajtueshmërisë dhe auditime të performancës, si dhe auditime të projekteve të financuara nga Banka Botërore.

Përzgjedhja e auditimeve për sezonin e auditimit 2026–2027 bëhet duke u bazuar në mandatin, analizën e rrezikut, prioritetet e auditimit, ndikimin e mundshëm në menaxhimin e financave publike dhe burimet në dispozicion të ZKA-së. Në këtë proces merren parasysh edhe çështjet e evidentuara në auditimet e mëparshme, kërkesat e Kuvendit të Kosovës dhe informatat e siguruara nga palët e interesit.

Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë synojnë të vlerësojnë, përkatësisht, nëse pasqyrat financiare paraqesin drejt gjendjen financiare dhe rezultatet e organizatave, si dhe nëse aktivitetet, transaksionet dhe përdorimi i fondeve publike janë në përputhje me legjislacionin dhe kërkesat e zbatueshme. Ndërkaq, auditimet e performancës vlerësojnë ekonomicitetin, efikasitetin dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve publike, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit dhe rritjes së vlerës për paranë publike. Për përzgjedhjen e temave të auditimit të performancës merren parasysh ndikimi i mundshëm në mirëqenien e qytetarëve, përmirësimi i qeverisjes dhe mundësia për të kontribuar në përmirësimin e shërbimeve publike. Gjithashtu, gjatë këtij procesi zhvillohen konsultime me shoqërinë civile dhe organizatat joqeveritare (OJQ).

Përzgjedhja e ndërmarrjeve publike për auditim mbështetet në rëndësinë e shërbimeve që ato ofrojnë, ndikimin në jetën e qytetarëve, vëllimin e buxhetit dhe të shpenzimeve, si dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre. Vëmendje u kushtohet veçanërisht ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime me rëndësi të veçantë publike, si: furnizimi me ujë, energjia, transporti dhe shërbimet e higjienës. Në përzgjedhje merren parasysh edhe rezultatet e auditimeve të mëparshme dhe kërkesat për auditim nga Kuvendi i Kosovës.

Baza ligjore për hartimin e Planit Vjetor të Auditimit (PVA) është neni 20 i Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, i cili përcakton obligimin e Auditorit të Përgjithshëm për hartimin e këtij plani. PVA-ja i dorëzohet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) çdo vit, deri më 31 tetor, dhe përfshin aktivitetet e planifikuara audituese për sezonin përkatës. Plani Vjetor i Auditimit për sezonin 2026–2027 paraqet auditimet e planifikuara, temat dhe objektivat përkatëse, afatet kohore, burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme, si dhe rreziqet që mund të ndikojnë në zbatimin e tij. Përmes këtij plani, ZKA-ja synon të sigurojë mbulim të përshtatshëm të sektorit publik, përdorim sa më efikas të kapaciteteve në dispozicion dhe rritje të ndikimit të auditimit në llogaridhënien dhe menaxhimin e financave publike.

4. AUDITIMET - LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE

Sipas Standardit Ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) 100 – Parimet Themelore të Auditimit të Sektorit Publik, auditimet e sektorit publik ndahen në tri lloje kryesore: auditime financiare, auditime të pajtueshmërisë dhe auditime të performancës.

4.1. Llojet e auditimeve

Në përputhje me mandatin dhe fushëveprimin e ZKA-së, gjatë sezonit 2026/27 do të kryhen këto lloje të auditimeve:

- **Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë** të organizatave buxhetore dhe të ndërmarrjeve publike përfshirë auditimet e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta;
- **Auditime të pajtueshmërisë** dhe
- **Auditime të performancës,** përfshirë auditimet e teknologjisë së informacionit.

Auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë përfshin auditimin e pasqyrave financiare vjetore dhe vlerësimin e pajtueshmërisë së aktiviteteve dhe transaksioneve me kërkesat ligjore të zbatueshme, me qëllim që të vlerësohet nëse:

I. pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare dhe rezultatet financiare të institucionit, përfshirë ekzekutimin e buxhetit;

II. transaksionet dhe aktivitetet financiare janë në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të zbatueshme dhe fondet publike përdoren për qëllimet e miratuara;

III. sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm janë të përshtatshme dhe funksionojnë në mënyrë efektive, për aq sa kjo përfshihet në objektivat dhe fushëveprimin e auditimit, si dhe nëse funksioni i auditimit të brendshëm përmbush kërkesat e zbatueshme.

Objektivat e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë përkufizohen si siguri e arsyeshme, e cila u ofrohet shfrytëzuesve të Pasqyrave Financiare, nëse Pasqyrat Financiare të audituara janë në tërë kuptimin material të vërteta dhe të drejta (apo të paraqitura drejt) dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet[1]. Varësisht nga burimi i kritereve, auditori kryen auditimin dhe formon një opinion me nivelin e zgjedhur të sigurisë, në përputhje me kërkesat në SNISA 2000[2].

Në Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA-në ky lloj auditimi është përcaktuar si auditim i detyrueshëm i rregullsisë dhe, me qëllim të përmbushjes së kësaj kërkese, ky auditim nënkupton auditimin financiar të kombinuar me auditimin e pajtueshmërisë.

1 "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë pajtueshmëri me aktet apo rezolutat e legjislaturës apo instrumente tjera statutore, direktiva dhe udhëzues të nxjerra nga organet e sektorit publik me kompetenca të përcaktuara me statut, të cilave pritet t'u përmbahet entiteti i audituar. Thënë ndryshe, është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira.

2 Auditimi Financiar (Parimet e AF-së SNISA 200-299, Standardet e AF SNISA 2000-2899, Udhëzimi Plotësues i AF GUID 2900-2999)

Auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë kryhet çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit mandatore për OB-të individuale dhe ndërmarrjet publike publikohen deri më 30 qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur dorëzohet në Kuvend Raporti Vjetor i Auditimit (RVA), i cili përfshin:

1. Opinionin e auditimit *të Raportit të Qeverisë për Buxhetin e Kosovës për vitin 2025, përfshirë gjetjet dhe rekomandimet;* dhe
2. Përmbledhja e rezultateve të auditimeve individuale të të gjitha Institucioneve publike, përfshirë auditimet financiare dhe ato të pajtueshmërisë në të gjitha Organizatat Buxhetore, Ndërmarrjet Publike si dhe auditimet e tjera të performancës).

Auditimi i pajtueshmërisë – Objektivi i auditimit të pajtueshmërisë është të vlerësojë nëse aktivitetet, transaksionet dhe veprimet e entiteteve publike të audituara janë në përputhje me kriteret e zbatueshme, të përcaktuara në ligje dhe akte nënligjore, politika, vendime, standarde, kontrata, memorandume mirëkuptimi dhe kërkesa të tjera përkatëse, si dhe t'u ofrojë përdoruesve të synuar informacion dhe përfundime mbi rezultatet e këtij vlerësimi.

Auditimi i pajtueshmërisë përfshin aspektet e rregullsisë (respektimi/bindja me kriteret formale siç janë ligjet, rregulloret dhe marrëveshjet përkatëse) dhe/ose konformitetit (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publikë). Varësisht nga burimi i kritereve, auditori kryen auditimin dhe formon një përfundim me nivelin e zgjedhur të sigurisë, në përputhje me kërkesat në SNISA 4000[3].

Auditimi i performancës paraqet një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e:

- **ekonomicitetit** (minimizimi i kostove të burimeve);
- **efikasitetit** (përfitimi sa më i madh nga burimet në dispozicion); dhe
- **efektivitetit** (përmbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara).

Fushat, objektivat, koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek njërën ose një kombinimin të këtyre tri qasjeve:

- qasjen e orientuar në **rezultate,** e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;
- qasjen e orientuar në **problem,** e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit/eve;
- qasjen e orientuar në **sistem,** e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese.

Në kuadër të auditimit të performancës përfshihet edhe Auditimi i Teknologjisë së Informacionit (TI-së), që përkufizohet si ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të TI-së dhe kontrollet e ndërlidhura me

3 Auditimi i pajtueshmërisë (Parimet e AP-së SNISA 400-499, Standardet e AP SNISA 4000-4899, Udhëzimi plotësues i AP 4900-4999).

to, për të përfituar siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së dhe kontrolleve lidhur me këto sisteme. Pavarësisht nga burimi i kritereve, auditori kryen auditimin dhe formon një përfundim me nivelin e zgjedhur të sigurisë, në përputhje me kërkesat në SNISA 3000[4].

4.2. Procesi i auditimeve

A. Procesi i auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimit Financiar dhe të Pajtueshmërisë (Metodologjia e qasjes së kombinuar) dhe SNISA-t. Auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë kryhet nëpër disa hapa duke filluar nga njohja e entitetit dhe analiza e rreziqeve dhe vazhdon me:

- planifikimin e auditimit;
- ekzekutimin e auditimit;
- dhënien e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit, raportimin në Kuvend dhe informimin e opinionit publik (publikimi i raporteve); dhe
- përcjelljen e adresimit të rekomandimeve të auditimit (plani i veprimit).

4 Auditimi i Performancës (Parimet e AP SNISA 300-399, Standardet e AP SNISA 3000-3899, Udhëzuesi plotësues i AP GUID 3900-3999).

Grafiku 1: Fazat e procesit të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë.



Faza 1. Planifikimi përfshin dy periudha:

- **Planifikimi i përgjithshëm i auditimit** ka për qëllim mbledhjen e sa më shumë informacioneve lidhur me entitetin që auditohet, gjë që realizohet në mënyrë efektive përmes punës përgatitore dhe takimeve me menaxhmentin e lartë të entitetit.
- **Planifikimi i detajuar i auditimit** përfshin zhvillimin e një plani të qartë dhe të strukturuar, i cili bazohet në analizën fillestare, vlerësimin e rreziqeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm. Në këtë fazë përcaktohen objektivat specifike të auditimit, fushat me prioritet të lartë dhe procedurat thelbësore që do të zbatohen. Qëllimi është të sigurohet që auditimi të kryhet në mënyrë efektive dhe efikase, duke mbështetur arritjen e rezultateve të besueshme. Të gjitha këto përfshihen dhe dokumentohen në Memorandumin e Planifikimit të Auditimit.

Faza 2. Ekzekutimi i auditimit përfshin zbatimin praktik të planit të auditimit, ku auditorët mbledhin, testojnë dhe analizojnë dëshmitë për të vlerësuar funksionimin e kontrolleve dhe besueshmërinë e informacionit financiar apo operacional. Në këtë fazë realizohen testet thelbësore dhe analitike për të konfirmuar gjetjet. Rezultatet paraprake diskutohen me menaxhmentin për sqarime dhe komente.

Përfundimet dhe vlerësimet përmblidhen në draft-raportin e auditimit, i cili paraqet gjetjet, rekomandimet dhe vlerësimin e përgjithshëm të performancës dhe kontrollit të brendshëm të entitetit.

Faza 3. Raportimi përfshin përmbledhjen dhe finalizimin e konkluzioneve të auditimit, të bazuara në dëshmitë e mbledhura gjatë fazës ekzekutive. Në këtë fazë, auditorët hartojnë raportin përfundimtar të auditimit, i cili përfshin opinionin zyrtar mbi Pasqyrat Financiare dhe vlerësimin e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret përkatëse. Raporti i nënshtrohet procesit të **kontrollit të cilësisë** dhe **aprovimeve zyrtare** brenda institucionit të auditimit, për të siguruar saktësi dhe objektivitet. Pas miratimit, raporti publikohet dhe u dërgohet autoriteteve relevante dhe palëve të interesit, duke përmbyllur kështu ciklin e auditimit me **opinione dhe konkluzione zyrtare** që reflektojnë gjendjen reale të entitetit të audituar.

Faza 4. Përcjellja e rekomandimeve të auditimit realizohet përmes auditimeve pasuese, me qëllim të verifikimit të zbatimit të tyre nga ana e entitetit të audituar. Pas pranimit të raportit final të auditimit, entiteti është i obliguar të hartojë planin e veprimit, ku përcakton masat dhe afatet për zbatimin e rekomandimeve, dhe ta dërgojë atë në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) brenda afatit të përcaktuar.

B. Procesi i auditimit të performancës dhe auditimit të pajtueshmërisë bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimit të Performancës dhe SNISA-t. Auditimi i performancës dhe ai i pajtueshmërisë kanë qasje të njëjtë dhe kryhen nëpër fazat në vijim:

Grafiku 2: Fazat e procesit të auditimit të performancës dhe të auditimit të pajtueshmërisë



Faza 1. Planifikimi përfshin propozimin e temave për auditim dhe përgatitjen e memove parastudimore. Propozimet vlerësohen sipas rëndësisë, ndikimit dhe përshtatshmërisë së tyre për auditim. Gjatë kësaj faze, ekipi i auditimit zhvillon një analizë fillestare për të kuptuar më mirë fushën që do të auditohet. Në këtë kuadër, përcaktohet qartë problemi i auditimit, qëllimi dhe objektivat, si dhe fushëveprimi dhe motivi i auditimit, për të siguruar që procesi të jetë i fokusuar, i qëllimshëm dhe në përputhje me standardet profesionale.

Faza 2. Faza ekzekutive e auditimit përfshin zbatimin praktik të planit të auditimit për të mbledhur dëshmi të mjaftueshme dhe të besueshme. Gjatë kësaj faze, ekipet e auditimit testojnë proceset, analizojnë të dhënat dhe shqyrtojnë kontrollin e brendshëm për të vlerësuar performancën e entitetit. Auditorët kryejnë procedura të ndryshme, përfshirë verifikime, intervista dhe analiza krahasuese. Qëllimi është të identifikohen mangësitë, rreziqet dhe mundësitë për përmirësim. Të gjitha gjetjet dokumentohen me kujdes për të mbështetur konkluzionet. Në përfundim, hartohet draft-raporti i auditimit me gjetjet dhe rekomandimet paraprake.

Faza 3. Raportimi përfshin përfundimin dhe paraqitjen e gjetjeve të auditimit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme. Ekipi i auditimit përgatit raportin përfundimtar, i cili duhet të jetë objektiv, i saktë, gjithëpërfshirës dhe i bazuar në dëshmi. Para publikimit, raporti i nënshtrohet kontrollit të cilësisë dhe aprovimeve zyrtare, për të siguruar që përmbajtja e tij është e drejtë dhe profesionale. Pasi të miratohet, raporti bëhet publik dhe u dërgohet palëve të interesit, duke përmbyllur kështu procesin e auditimit të performancës.

Faza 4. Përcjellja e auditimit ndodh pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore, kur Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA-ja) mund të vlerësojë se sa progres ka bërë entiteti në zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Ky vlerësim bëhet përmes një auditimi përcjellës, i cili synon të konfirmojë nëse veprimet e ndërmarra janë efektive dhe të qëndrueshme. Sipas standardeve të auditimit dhe Doracakut për auditimet e performancës, auditimet përcjellëse nuk kryhen domosdoshmërisht për çdo auditim të mëparshëm. Vendimi për ta zhvilluar një auditim përcjellës merret në bazë të rëndësisë dhe ndikimit të temës së auditimit.

Procesi i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë në ZKA monitorohet dhe rishikohet nga Departamenti për Menaxhimin e Cilësisë, i cili ka përgjegjësi të sigurojë që auditimet kryhen në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Ndërsa për auditimet e performancës dhe teknologjisë së informacionit procesi i sigurimit të cilësisë kryhet përmes rishikimeve kolegiale. Ky proces ndihmon në ruajtjen e cilësisë, profesionalizmit dhe besueshmërisë së punës audituese.

5. OBJEKTIVAT E PLANIT VJETOR TË AUDITIMIT

Zyra Kombëtare e Auditimit planifikon punën audituese në baza vjetore, e cila bazohet në objektivat e Planit Strategjik. Objektivat e ZKA-së për sezonin e auditimit 2026/27 janë në përputhje me kërkesat ligjore, të cilat synojnë rritjen e ndikimit në përmirësimin e qeverisjes dhe mundësinë për të shtuar vlerë në menaxhimin e financave publike.

Në sezonin e auditimit 2026/2027 janë planifikuar 155 auditime.

Grafiku 3: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara për sezonin e auditimit 2026/2027 në mënyrë grafike



Të gjitha auditimet (me përshkrim) janë paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij dokumenti.

Raportet individuale për auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë do të finalizohen deri më 30 qershor 2027, në përputhje me afatin ligjor. Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Kosovës pritet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht të vitit 2027.

Auditimet e performancës, pajtueshmërisë dhe të projekteve do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe jo domosdoshmërisht do të publikohen në kuadër të sezonit të auditimit 2026/2027.

Angazhimi i burimeve njerëzore në procese auditimi është bërë duke marrë parasysh: disponueshmërinë me burimet njerëzore, kualifikimin dhe përvojën e stafit, madhësinë e buxhetit që auditohet, rrezikshmërinë, si dhe kompleksitetin e temës së auditimit.

5.1. Objektivi i auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë

Objektivi i auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë është të ofrojë siguri të pavarur dhe objektive për Kuvendin e Republikës së Kosovës, qytetarët, shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesit, përmes auditimit të pasqyrave vjetore financiare (PVF) dhe vlerësimit të pajtueshmërisë së aktiviteteve, transaksioneve dhe operacioneve të subjekteve të audituara me legjislacionin në fuqi. Këto auditime kryhen si auditime të kombinuara, ku ZKA-ja shpreh opinionin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare, ndërsa për pjesën e pajtueshmërisë paraqet konkluzion lidhur me atë nëse aktivitetet dhe transaksionet e audituara janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative të zbatueshme. Përmes këtyre auditimeve, ZKA-ja synon të rritë llogaridhënien dhe transparencën në menaxhimin e fondeve publike, të forcojë mbikëqyrjen publike dhe të kontribuojë në përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit financiar në sektorin publik.

Në këtë grup përfshihen edhe 20 auditime të kontraktuara, prej të cilave 11 janë auditime të komunave dhe 9 të institucioneve të pavarura. Këto auditime do të kryhen nga një kompani private e auditimit, ndërsa monitorimi i procesit dhe përcaktimi i opinionit të auditimit mbeten përgjegjësi e Auditorit të Përgjithshëm, në përputhje me metodologjinë e ZKA-së dhe SNISA-t.

ZKA-ja ka vendosur të përfshijë edhe dy auditime të pasqyrave financiare për qëllime të veçanta të ndërmarrjes publike KEK, të kërkuara për nevojat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM). Kërkesat e tilla trajtohen në mënyrë të strukturuar, duke marrë parasysh mandatin ligjor, rëndësinë dhe mundësitë e ZKA-së për realizimin e tyre

ZKA-ja ka mekanizma të brendshëm në funksion të trajtimit të kërkesave të ndryshme që vijnë nga palët e jashtme për auditime me kërkesë, dhe si të tilla trajtohen në mënyrën efektive.

Mënyra e përzgjedhjes së auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë.

Përveç auditimeve të detyrueshme financiare dhe të pajtueshmërisë të përcaktuar me ligj, fokus i veçantë i është dhënë përzgjedhjes së auditimeve të pajtueshmërisë, ndërmarrjeve publike dhe projekteve të Bankës Botërore.

Fushëveprimi i auditimit apo qasja e auditimit nuk do të ndryshojë nga vitet paraprake, por do të ketë fokus më të madh në fushat që mund të pritet apo vlerësohet që mund të jenë më me rrezik për ndonjë shmangie nga rregullativa ligjore.

Planifikimi i auditimit është pjesë shumë e rëndësishme e procesit të auditimit, për arsye se i jep drejtim auditimit, duke u bazuar në një vlerësim të rreziqeve që kanë të bëjnë me entitetin, prandaj, një auditim efektiv dhe efikas mbështetet mbi planifikimin në mënyrën e duhur të proceseve dhe procedurave.

Ne kemi zhvilluar një strategji dhe qasje të detajuar për punën specifike, në mënyrë që auditimi të kryhet në mënyrë efikase dhe në kohën e duhur. Qëllimi ynë është që të bëhet i sigurt fakti se çështjeve të auditimit iu kushtohet rëndësia e duhur dhe çështjet problematike identifikohen dhe trajtohen siç duhet brenda mandatit kushtetues dhe ligjor. Do të kemi parasysh dhe do të bëjmë një përshkrim të natyrës, kohëzgjatjes dhe shtrirjes së procedurave të nevojshme të auditimit. Të njihet entiteti dhe mjedisi ku vepron, përfshirë këtu kontrollet e brendshme, aq mjaftueshëm sa të jemi në gjendje të identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimeve materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato si rrjedhojë e mashtrimeve ose gabimeve, dhe aq mjaftueshëm sa të jemi të aftë të krijojmë dhe kryejmë procedurat e mëtejshme të auditimit.

5.1.1. Rreziqet e auditimit

Në kuadër të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), analiza e rrezikut fillon nga përcaktimi dhe mirëmbajtja e Universit të Auditimit, i cili përfshin të gjitha subjektet, programet, fondet, proceset dhe fushat që mund të jenë objekt i auditimit, në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor të ZKA-së. Universi i auditimit është gjithëpërfshirës dhe i përditësuar, duke integruar informacion financiar dhe jo-financiar, rezultatet e auditimeve të mëparshme, nivelin e zbatimit të rekomandimeve, rëndësinë buxhetore, kompleksitetin e aktiviteteve, ndryshimet institucionale, si dhe faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në rrezikun e keqmenaxhimit, mospërputhjes, mashtrimit apo performancës së dobët. Ky univers shërben si bazë për një qasje të strukturuar dhe të dokumentuar të vlerësimit të rrezikut dhe përcaktimit të prioriteteve të auditimit.

Mbi bazën e Universit të Auditimit, ZKA-ja kryen një vlerësim sistematik dhe të krahasueshëm të rrezikut, duke kombinuar kriteret e rëndësisë/materialitetit, probabilitetit të ndodhjes së rrezikut dhe ndikimit të mundshëm në financat publike, ofrimin e shërbimeve dhe interesin publik. Rezultatet e kësaj analize përdoren për të renditur subjektet dhe fushat sipas nivelit të rrezikut dhe për të orientuar burimet e kufizuara të auditimit drejt atyre me ekspozimin më të lartë ndaj rrezikut. Procesi është dinamik dhe i bazuar në të dhëna, duke u rishikuar periodikisht në funksion të ndryshimeve në mjedisin e jashtëm, rezultateve të auditimeve, sinjaleve të reja të rrezikut dhe informacionit të disponueshëm. Në këtë mënyrë, analiza e rrezikut krijon lidhjen ndërmjet Universit të Auditimit → vlerësimit të rrezikut

→prioritizimit →planifikimit të portofolit të auditimeve → alokimit të burimeve, duke siguruar që programi i auditimit të ZKA-së të jetë i orientuar drejt fushave me rëndësi dhe rrezik më të lartë.

Grafiku 4: Procesi i analizës së rrezikut në ZKA



Për auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, para përgatitjes së planit audites, vlerësohen rreziqet për të gjitha institucionet. Si pjesë e punës për zhvillimin e planit vjetor të auditimit, ZKA-ja shqyrton edhe rreziqet domethënëse. Këto rreziqe janë rreziqe të vlerësuara të keqdeklarimeve materiale që sipas gjykimit të auditorëve kërkojnë vëmendje të veçantë gjatë auditimit, të cilat kanë rezultuar gjatë proceseve individuale të auditimit të OB-ve dhe janë evidentuar në RVA. Në këtë sezon auditimi, përveç çështjeve tjera, vëmendje do t'i kushtohet:

- **Keqklasifikimit të shpenzimeve nëpër OB-të -** Sipas Rregullores financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i Parave Publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara në planin kontabël. Po ashtu, UA 19/2009 për Planin Kontabël kërkon nga ZKA-ja dhe ZKF-ja që të sigurojnë se të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara në këtë UA.
- **Menaxhimit të pasurive financiare -** Rregullorja MF nr. 02/2013 mbi Menaxhimin e Pasurive në Organizata Buxhetore i obligon të gjitha organizatat të mbajnë regjistrat e pasurisë jofinanciare që kanë në menaxhimin e tyre si dhe vazhdimisht të bëjnë azhurnimin e tyre, varësisht nga blerjet/ përvetësimet e reja apo shqyrtimit sistematik të gjendjes së tyre të përdorimit.

- **Llogarive të arkëtueshme -** Rregullorja MF nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar i obligon OB-të të mbajnë regjistrat e Llogarive të Arkëtueshme. Të arkëtueshmet paraqesin një zë të rëndësishëm për qëllime të menaxhimit financiar. OB-të që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të shumave të faturuara e të paarkëtuara, të cilat shërbejnë si bazë për raportimin financiar. OB-të janë të detyruara të bëjnë inkasimin e LLA-ve në kohë reale, për faktin se vjetërsia e këtyre llogarive vështirëson inkasimin dhe rrezikon me humbje financiare për OB-të. dhe
- **Detyrimeve të papaguara dhe kontingjente -** Ligji i buxhetit dhe rregullativa sekondare për Shpenzimin e Parasë Publike kufizon hyrjen e OB-ve në detyrime, meqë obligohen që porosinë e mallit/punëve (urdhërblerjen) ta bëjnë vetëm kur ka mjete në dispozicion. Detyrimet e papaguara/ kontingjente paraqesin faturat e pranuara për punët/shërbimet e përfunduara nga operatorët ekonomik, por të cilat nuk janë paguar. Për shkak të përdorimit të kontabilitetit në para të gatshme, gjendja e detyrimeve të papaguara vetëm mund të shpaloset në pasqyrat financiare, aq më tepër kur një qasje e tillë e mbledhjes së informatave jashtë SIMFK-së, lë hapësirë për gabime të mundshme në raportimin apo shpalosjen e tyre.

Në aspektin e pajtueshmërisë së aktiviteteve, transaksioneve dhe veprimeve të institucioneve publike, me kriteret e zbatueshme, të përcaktuara në ligje dhe akte nënligjore, politika, vendime, standarde, kontrata, memorandume mirëkuptimi dhe kërkesa të tjera përkatëse, auditimi do të foksuhet në auditimin e zbatimit të aktiviteteve të prokurimit publik, në veçanti në projektet kapitale si dhe subvencionimin e fushave të ndryshme.

5.1.2. Përgjigjja e Auditimit

Në planifikimin e auditimit do të kemi fokus të veçantë ndaj këtyre rreziqeve. Si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve do të bëjmë punë shtesë duke dizajnuar program të veçantë të auditimit për klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet e papaguara/kontingjente.

Ne do të shqyrtojmë sistemet tjera të kontabilitetit dhe kontrollet e menaxhmentit, vetëm aq sa ne e konsiderojmë të nevojshme për të kryer një auditim efektiv. Si rezultat, shqyrtimi ynë mund të mos zbulojë të gjitha mangësitë apo të gjitha përmirësimet që mund të bëhen. Aty ku ne zbulojmë çfarëdo mangësie apo dobësie të rëndësishme, ne do t'i raportojmë me rekomandime për përmirësim.

Në planin vjetor të auditimit, për institucionet e mëdha dhe komplekse, fokusi bëhet te shpërndarja e stafit sipas kualifikimeve, përvojës dhe kompetencës profesionale.

Me qëllim të mbulimit të auditimeve mandatore, krahas burimeve njerëzore, të cilat nuk mund t'i mbulojmë me stafin e rregullt, ZKA-ja bën vlerësimin e rreziqeve për auditimet, ashtu që auditimet me më pak rreziqe kontraktohen nga kompani private të licencuara të auditimit.

5.2. Objektivi i auditimeve të pajtueshmërisë

Objektivi i auditimit të pajtueshmërisë është t'u ofrojë përdoruesve të synuar informacione për atë nëse entitetet publike të audituara i përmbahen ligjeve, akteve legjislative, politikave, udhëzuesve, vendimeve,

kodeve të vendosura, standardeve dhe kushteve të dakorduara të kontratave dhe memorandumeve të mirëkuptimit. Këto auditime kryhen në përputhje me kërkesat në SNISA 400 dhe 4000.

Duke marrë parasysh rëndësinë që aktivitetet si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal të kryhen në pajtueshmëri me autoritetet, për sezonin e auditimit 2026/2027 kemi planifikuar 10 auditime të veçanta të pajtueshmërisë, përderisa 3 auditime janë vazhdimësi e planit të vitit paraprak.

Objektivi dhe fushëveprimi i këtyre auditimeve do të përcaktohen pas analizimit dhe identifikimit të rreziqeve në fusha specifike.

5.3. Objektivi i auditimeve të performancës dhe TI-së

Objektivi i auditimeve të performancës dhe të teknologjisë së informacionit është të vlerësojë nëse programet, aktivitetet dhe sistemet e institucioneve publike menaxhohen në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësimin e qeverisjes, përdorimit të burimeve publike dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Për sezonin e auditimit 2026/2027, ZKA-ja do t'i kushtojë rëndësi të veçantë fushave me ndikim në mirëqenien e qytetarëve, zhvillimin e qëndrueshëm dhe funksionimin e institucioneve publike, duke përfshirë:

- shëndetin e mirë dhe mirëqenien;
- sigurimin e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit ushqimor dhe praktikave bujqësore;
- paqen, drejtësinë dhe institucionet e qëndrueshme;
- industrinë, inovacionin dhe infrastrukturën;
- qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme;
- prokurimin publik të qëndrueshëm.

Me qëllim të prioritizimit të fushave me interes dhe njëkohësisht maksimizimit të burimeve dhe rritjes së ndikimit përmes auditimeve të performancës në mirëqenien e qytetarëve, Zyra Kombëtare e Auditimit zhvillon një proces deri te përzgjedhja e fushave/temave të auditimit. Procesi ka përfshirë qasjen strategjike dhe hulumtimet për fushat përkatëse, bazuar edhe në strategjinë trevjeçare për auditimin e TI-së. Përveç këtyre, janë analizuar raportet e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë apo mëvetshme të pajtueshmërisë për identifikimin e mangësive kyçe, si dhe janë ftuar auditorët të propozojnë tema bazuar në njohuritë e tyre dhe problematikat e hasura gjatë auditimeve paraprake.

Përveç hulumtimeve dhe propozimeve nga auditorët e ZKA-së, është organizuar edhe tryezë për të diskutuar me palët e jashtme të interesit, pra me Shoqërinë Civile si: organizatat joqeveritare, organizatat profesionale, komunitetin e donatorëve dhe ekspertët e fushave, për diskutimin e temave duke u dhënë mundësi pjesëmarrësve për ofrimin e propozimeve. Po ashtu, në përputhje me legjislacionin në fuqi për AP-në dhe ZKA-në, merren parasysh edhe kërkesat e mundshme për auditim të paraqitura nga Qeveria apo Kuvendi i Republikës së Kosovës.

ZKA-ja synon të promovojë efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike përmes këtyre auditimeve:

Qëllimi: Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Kujdesi ndaj pacientëve në Klinikën e Onkologjisë. Sigurimi i trajtimit në kohë dhe të vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kancerogjene kërkon organizim efektiv të shërbimeve dhe furnizim të qëndrueshëm me barna. Në vitin 2025 janë raportuar 3,775 raste të reja me sëmundje malinje dhe beninje, një rritje prej 3.6% krahasuar me vitin 2024. Përqendrimi i shërbimeve në Klinikën e Onkologjisë dhe kërkesa e lartë për trajtim shtojnë nevojën për planifikim të barnave, stafit, pajisjeve dhe termineve.

Qëllimi: Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Kontrolli i cilësisë së produkteve ushqimore të qumështit dhe vezëve. Produktet e qumështit dhe vezëve janë pjesë e rëndësishme e ushqimit të përditshëm dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin publik dhe sigurinë ushqimore. Produkte të kontaminuara tregojnë rreziqe të mundshme për konsumatorët dhe ngrenë shqetësime nëse inspektimet dhe kontrollet kryhen në mënyrë efektive, si për produktet vendore ashtu edhe për ato të importuara, para se të dalin në treg. Prandaj, është e rëndësishme të sigurohet që kontrollet e cilësisë dhe sigurisë ushqimore të identifikojnë rreziqet në kohë dhe të parandalojnë që produktet e pasigurta të arrijnë te konsumatorët.

Qëllimi: Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Efektiviteti i furnizimit me ujë të pijshëm në Kosovë. Furnizimi i sigurt dhe i vazhdueshëm me ujë të pijshëm është një parakusht themelor për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mirëqenien e qytetarëve. Në Kosovë për vitin 2024, ofruesit e shërbimeve kanë mbuluar vetëm 83% të popullatës me shërbimet e ujit, ndërsa pjesa tjetër vazhdon të mbetet jashtë shërbimeve të rregullta të ujësjellësit. Edhe pse sipas të dhënave të raportuara 97.3% e konsumatorëve kanë pasur furnizim 24-orësh në vitin 2024, rreth 11,200 konsumatorë kishin ndërprerje. Shqetësimet lidhur me ndërprerjet dhe reduktimet e furnizimit, dallimet në qasjen e qytetarëve në shërbime dhe nevojën për monitorim të vazhdueshëm, ngrenë çështjen nëse institucionet përgjegjëse po i përmbushin në mënyrë efektive qëllimet e tyre.

Qëllimi: Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Efektiviteti i pastrimit dhe mirëmbajtjes higjienike të objekteve publike në Kosovë. Pastrimi dhe mirëmbajtja higjienike e objekteve publike janë shërbime të vazhdueshme që financohen nga paratë publike dhe ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve. Shqetësimet lidhur me nivelin e pastërtisë, mungesën e materialeve higjienike, numrin e punëtorëve dhe ndërprerjen e shërbimeve në spitale, shkolla, kopshte, konvikte dhe objekte administrative ngrenë nevojën për të vlerësuar nëse institucionet po sigurojnë shërbime në përputhje me kërkesat e përcaktuara.

Qëllimi: Sigurimi i sistemeve të qëndrueshme të prodhimit ushqimor dhe praktikave bujqësore

Efektiviteti i planifikimit dhe monitorimit të programeve të mbështetjes për bujqësi dhe zhvillim rural. Bujqësia është një sektor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës, sigurinë ushqimore dhe përmirësimin e mirëqenies së fermerëve. Përmes Programit për Pagesa Direkte (subvencioneve) dhe

Programit për Zhvillim Rural (granteve), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural synon të mbështesë prodhimin bujqësor, të rritë konkurrueshmërinë e sektorit dhe të nxitë zhvillimin e qëndrueshëm rural. Andaj, është e rëndësishme të sigurohet që këto programe të planifikohen dhe monitorohen në mënyrë efektive, me ç'rast mbështetja financiare të orientohet sipas nevojave dhe prioriteteve të sektorit dhe të kontribuojë në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Qëllimi: Qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme

Efikasiteti dhe efektiviteti i ofrimit të shërbimeve të transportit publik nga Trafiku Urban. Transporti publik, veçanërisht në Prishtinë, është shërbim esencial që ndikon drejtpërdrejt në mobilitetin e qytetarëve, zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e jetës. Ofrimi i transportit publik të qasshëm, të rregullt dhe cilësor kontribuon në lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve, zvogëlimin e ngarkesës në trafik dhe uljen e ndotjes së ajrit. Prandaj, është e rëndësishme të vlerësohet nëse ky shërbim planifikohet, organizohet dhe menaxhohet në mënyrë efikase dhe efektive, për të siguruar shfrytëzimin optimal të burimeve dhe ofrimin e shërbimeve cilësore, të rregullta dhe në përputhje me nevojat e qytetarëve.

Qëllimi: Qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme

Ndërtimet e larta në komunën e Prizrenit. Procesi i lëshimit të lejeve të ndërtimit dhe mbikëqyrjes së ndërtimeve është i rëndësishëm për zhvillimin e planifikuar urban, sigurinë e ndërtimeve dhe respektimin e kërkesave ligjore. Sipas të dhënave të Thesarit për vitin 2025, Komuna e Prizrenit renditet e dyta në mesin e komunave të Kosovës për nga të hyrat e realizuara nga taksat për leje ndërtimore, me gjithsej 2,928,410.79 euro. Duke marrë parasysh këtë tregues dhe auditimet e mëparshme të realizuara në komunën e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Ferizajt, është planifikuar që auditimi i radhës të përfshijë Komunën e Prizrenit.

Qëllimi: Paqe, drejtësi dhe institucione të qëndrueshme

Agjenda e reformave

Instrumenti i BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor paraqet një mekanizëm të ri financiar dhe reformues, ku mbështetja financiare e BE-së është e kushtëzuar me përmbushjen e hapave të dakorduar të reformave. Institucione të ndryshme publike përfitojnë nga ky fond me kusht që i zbatojnë reformat. Ekziston rreziku që institucionet të vonohen në zbatimin e reformave dhe fondet të humbin sepse sipas marrëveshjes secila reformë ka afat të caktuar për zbatim. Andaj është e rëndësishme që të shohim nëse institucionet janë të koordinuara dhe kanë vendosur mekanizma adekuatë të kontrollit për ta menaxhuar zbatimin e Agjendës dhe për të siguruar përmbushjen në kohë të kushteve të pagesës.

Qëllimi: Prokurimi publik i qëndrueshëm

Efektiviteti i zbatimit të projektit të Autostradës Prishtinë–Gjilan në sigurimin e vlerës për para

Projekti i Autostradës Prishtinë–Gjilan është projekt strategjik me ndikim të lartë publik dhe financiar, por realizimi i tij është përcjellë me vonesa shumëvjeçare, ndryshime kontraktuale, punë shtesë,

probleme me shpronësime dhe paqartësi në menaxhimin e afateve dhe kostove. Edhe pse projekti ishte paraparë të përfundonte brenda një afati shumë më të shkurtër, ai ende ka mbetur i papërfunduar për një periudhë të gjatë, duke shtyrë përfitimet e pritura për qytetarët dhe ekonominë lokale. Prandaj është e rëndësishme që të vlerësohet nëse MMPHI-ja dhe institucionet përgjegjëse kanë planifikuar, menaxhuar dhe realizuar projektin e Autostradës Prishtinë–Gjilan në mënyrë efikase dhe efektive, duke siguruar zbatim brenda afateve, kontroll të kostove, menaxhim të rreziqeve dhe vlerë për para.

Qëllimi: Prokurimi publik i qëndrueshëm

Efikasiteti në ndërtimin e Stadiumit Rexhep Rexhepi

Stadiumi "Rexhep Rexhepi" në Drenas është financuar përmes investimeve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe Komunës së Drenasit. Projekti është realizuar në disa faza, ndërsa investimi për fazën e tretë dhe përfundimtare paraqet një angazhim të rëndësishëm financiar mbi pesë milionë euro. Përveç kësaj Komuna e Drenasit ka publikuar kontratë për rishikimin e projektit nga kategoria e dytë në kategorinë e katërt. Ndryshimet gjatë procesit të ekzekutimit kontratave paraqesin rrezik për jo-efikasitet. Punimet për rinovimin e stadiumit në Drenas kanë nisur prej disa vitesh, por janë zhvilluar me ritëm të ngadaltë, ashtu si në shumicën e objekteve sportive në vend. Ky stadium mund të përdoret edhe në Lojërat Mesdhetare të vitit 2030 andaj është e rëndësishme që të shqyrtohet nëse MKRS-ja dhe Komuna e Drenasit bëjnë planifikim efektiv dhe ekzekutim efikas të këtij projekti.

Qëllimi: Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Efektiviteti në ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve për personat e moshuar në nevojë

Shërbimet sociale për personat e moshuar në nevojë kanë rëndësi të veçantë për sigurimin e kujdesit, shëndetit dhe dinjitetit të tyre. Në Kosovë, këto shërbime organizohen dhe ofrohen nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal, përmes kujdesit rezidencial dhe shërbimeve në komunitet. Duke marrë parasysh ndjeshmërinë e kësaj kategorie, është e rëndësishme të shqyrtohet nëse burimet dhe kapacitetet në dispozicion menaxhohen në mënyrë optimale dhe nëse shërbimet ofrohen në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Qëllimi: Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Inspektimi për garantimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat

Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve dhe garantimi i kushteve të sigurta e të dinjitetshme të punës janë elemente thelbësore për mirëqenien sociale dhe sigurinë e tyre. Inspektimet e punës përbëjnë një mekanizëm të rëndësishëm për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të punës në sektorin privat në Kosovë, përfshirë respektimin e kontratave, orarit të punës, kushteve të punës dhe sigurisë në vendin e punës. Rastet e raportuara të aksidenteve në vendin e punës, përfshirë ato me pasoja fatale, si dhe shqetësimet lidhur me respektimin e të drejtave të punëtorëve, e theksojnë rëndësinë e këtyre inspektimeve. Në këtë kontekst, është e nevojshme të shqyrtohet mënyra e planifikimit, realizimit dhe përcjelljes së tyre, si dhe shfrytëzimi i burimeve në dispozicion.

Qëllimi: Paqe, drejtësi dhe institucione të qëndrueshme

Legalizimi i objekteve të ndërtuara pa leje në Komunën e Prishtinës

Legalizimi i objekteve të ndërtuara pa leje paraqet sfidë për planifikimin urban, zbatimin e ligjit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit. Vonesat në trajtimin e kërkesave, mungesa e informacionit të qartë për qytetarët dhe moszbatimi i njëtrajtshëm i procedurave mund të krijojnë pasiguri juridike për pronarët, të pengojnë regjistrimin e pronës dhe të ndikojnë në besimin e qytetarëve në institucionet publike. Për më tepër, legalizimi joefektiv mund të ndikojë në zbatimin e planeve urbanistike, sigurinë e ndërtimeve dhe trajtimin e barabartë të qytetarëve. Prandaj është e rëndësishme të vlerësohet nëse Komuna e Prishtinës e ka menaxhuar procesin e legalizimit të objekteve pa leje në mënyrë efektive, efikase dhe transparente, duke përfshirë trajtimin e kërkesave brenda afateve, zbatimin e kërkesave ligjore, monitorimin e procesit dhe informimin e qytetarëve, me qëllim identifikimin e pengesave dhe përmirësimin e këtij procesi.

Qëllimi: Inovacioni, Infrastruktura dhe Industrializimi

Moduli i Rekrutimit në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Moduli i rekrutimit në kuadër të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është zhvilluar gjatë vitit 2021, në kuadër të reformës së administratës publike dhe digjitalizimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore. Moduli është projektuar për të mundësuar zhvillimin elektronik të procedurave të rekrutimit, duke përfshirë aplikimin online, verifikimin e kandidatëve, testimin elektronik dhe publikimin e rezultateve. Përdorimi i tij nga institucionet publike ka filluar gradualisht gjatë viteve 2021–2022 dhe aktualisht paraqet platformën standarde për zhvillimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës. Përmes modulit të rekrutimit të SIMBNJ bëhet menaxhimi i rekrutimeve që prej procesit të aplikimit dhe deri te punësimi dhe vlerësimi i periudhës provuese të punësimit të kandidatëve në IRK.

Platforma e Cilësisë së Shërbimeve dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve nga ARKEP.

Shërbimet e internetit kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe digjitalizimin e shoqërisë, ndërsa cilësia e tyre ndikon drejtpërdrejt te qytetarët dhe bizneset. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) mundëson matjen dhe monitorimin e performancës së rrjeteve fikse dhe mobile. Megjithatë, është e rëndësishme që të dhënat e gjeneruara nga platforma të jenë të besueshme dhe të shfrytëzohen në mënyrë efektive për mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve të internetit në vendin tonë. Gjithashtu nëse, rezultatet e matjeve të cilësisë së shërbimeve shfrytëzohen për të mbështetur shqyrtimin efektiv dhe efikas të ankesave dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Moduli për menaxhimin e lëndëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka rol të rëndësishëm në sigurimin e ligjshmërisë dhe trajtimit të ankesave në procedurat e prokurimit publik. Për realizimin e këtij funksioni, OSHP mbështetet në Sistemin për Menaxhimin e Lëndëve (SML), të integruar në platformën e E-Prokurimit, dhe në ueb-faqen zyrtare për publikimin e dokumenteve dhe vendimeve. Andaj rëndësi të veçantë kanë kontrollet e

sistemit, veçanërisht në përzgjedhjen dhe angazhimin e ekspertëve shqyrtues, aktivitetet manuale dhe gjurmueshmërinë e veprimeve të përdoruesve.

Operimi i sistemeve të TI-së në Kuvendin e Kosovës

Operimi i sistemeve të TI-së në Kuvendin e Kosovës është i rëndësishëm për funksionimin efikas të institucionit, sigurinë e informacionit dhe vazhdimësinë e shërbimeve. Mangësitë në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e këtyre sistemeve mund të ndikojnë në punën e Kuvendit dhe mbrojtjen e të dhënave. Kjo temë është përzgjedhur me kërkesë të Kuvendit të Kosovës. Përmes auditimit synohet të vlerësohet nëse sistemet e TI-së menaxhohen dhe operojnë në mënyrë efektive, efikase dhe të sigurt, si dhe të identifikohen mangësitë dhe masat e nevojshme për përmirësimin e funksionimit dhe sigurisë së tyre.

6. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

ZKA-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës i cili miratohet nga Kuvendi i Kosovës, sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Bazuar në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2026, buxheti i ZKA-së është 3,532,633€, duke mbetur pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraprak. Buxheti është i ndarë në katër kategori ekonomike: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shërbime komunale dhe investime kapitale.

Me buxhetin vjetor janë miratuar 185 vende pune, aktualisht ka të punësuar 172 punonjës, prej të cilëve 137 janë të angazhuar drejtpërdrejt në auditim, kurse pjesa tjetër në shërbimet tjera menaxheriale, administrative dhe mbështetëse.

Për të arritur qëllimet dhe objektivat strategjike, ZKA-ja është duke investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore. Auditorëve do t'iu mundësohet vijimi i trajnimeve dhe arritja e normativit të përcaktuar në SNISA-t për arsimin e vazhdueshëm profesional, si një nga faktorët themelorë për kryerjen e auditimeve me kompetencë, cilësi dhe sipas kërkesave të SNISA-ve.

Duke marrë parasysh kërkesat për auditime, rritjen e portofolit të auditimeve dhe shtimin e numrit të auditimeve të pajtueshmërisë, numri i auditorëve nuk është i mjaftueshëm për t'i mbuluar të gjitha këto auditime.

Në mungesë të burimeve të mjaftueshme dhe me qëllim të orientimit të burimeve në fushat me rrezik, ZKA-ja është e detyruar që çdo vit të kontraktojë kompani private të auditimit për të përkrahur auditimin financiar të detyrueshëm me ligj të një numri të caktuar të organizatave buxhetore.

7. ZBATIMI I PLANIT VJETOR

Plani vjetor i auditimit do të zbatohet nga 1 shtatori 2026 deri më 31 gusht 2027.

Për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, ZKA-ja përgatit plane operative auditimi të detajuara, sipas fushave, organizatave buxhetore dhe projekteve të caktuara, shumave të buxhetit, ku përcaktohet edhe përbërja e ekipeve audituese për realizimin e këtij plani vjetor të auditimit. Ky proces mbështetet nga Sistemi i Teknologjisë së Informacionit për Auditimin - SITA.

Mbi këtë bazë, ZKA-ja përgatit edhe planin kohor për përfundimin e sezonit të auditimit për secilin projekt auditimi, i cili inkorporohet në SITA dhe realizimi i tij monitorohet në vazhdimësi.

Prishtinë, tetor 2026

Vlora Spanca

Auditore e Përgjithshme

Shtojca 1. Subjektet/temat dhe shuma e buxhetit që do të auditohet.

AUDITIMET FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMERISË

Tabela 1. Institucionet e nivelit qendror dhe lokal, ndërmarrjet publike dhe projektet që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët

Institucione të nivelit qendror dhe RVA [53]

Nr.	Organizata	Buxheti[5] €
1	Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2026	3,955,595,904
2	Kuvendi i Kosovës	10,126,353
3	Zyra e Presidentit	5,808,953
4	Zyra e Kryeministrit	21,192,951
5	Ministria e Financave (Klauzola 10,350,000)	1,194,770,851
6	Ministria për Digjitalizim dhe Administratë Publike	-
7	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	95,684,279
8	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit	27,238,732
9	Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit (Klauzola 21,289,422)	310,841,268
10	Ministria e Shëndetësisë (Klauzola 10,368,050)	102,407,847
11	Ministria e Kulturës dhe Turizmit	98,040,794
12	Ministria e Arsimit dhe Shkencës (Klauzola 4,000;000)	110,062,784
13	Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare	-
14	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	-
15	Ministria për Komunitete dhe Kthim	5,594,753
16	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	6,639,573
17	Ministria E Ekonomisë (Klauzola (44,531,926)	78,957,820
18	Ministria e Punëve të Brendshme	247,882,339
19	Ministria e Drejtësisë	56,947,471
20	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	52,012,049
21	Ministria e Mbrojtjes	216,097,561

5 Të dhënat buxhetore janë bazuar në Ligjin nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026. Ky ligj është miratuar para themelimit të katër ministrive të reja: Ministrisë për Digjitalizim dhe Administratë Publike, Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrisë së Sportit dhe Rinisë. Buxhetet për këto ministri janë përcaktuar pas themelimit të tyre.

22	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës	197,679,248
23	Ministria e Zhvillimit Rajonal	5,070,299
24	Fondi i Sigurimit Shëndetësor	10,834,992
25	Ministria e Sportit dhe Rinisë	-
26	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*	927,805
27	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës*	2,014,037
28	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare*	1,975,420
29	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit*	979,665
30	Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës	961,472
31	Agjencia Kosovare e Privatizimit	4,832,947
32	Fondi në Mirëbesim	-
33	Organi Shqyrtues i Prokurimit	556,924
34	Universiteti i Prishtinës	35,926,238
35	Gjykata Kushtetuese	2,437,646
36	Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës	472,188
37	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	384,995
38	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	377,625
39	Radio Televizioni i Kosovës	8,960,000
40	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*	666,453
41	Këshilli Prokurorial i Kosovës	19,621,593
42	Agjencia për Informim dhe Privatësi*	535,198
43	Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar	906,362
44	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit*	410,181
45	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	447,189
46	Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës	870,876
47	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1,593,935
48	Komisioni i Pavarur për Media	1,394,533
49	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	6,795,541
50	Institucioni i Avokatit të Popullit	1,489,535
51	Akademia e Drejtësisë*	888,004
52	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	38,514,055
53	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës*	3,176,988

**Institucionet e Pavarura, 9 auditime të cilat do të përkrahen nga kompania private e auditimit.*

Janë planifikuar tri auditime me informacion të klasifikuar, në tri ministri: Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Institucione të nivelit lokal/komuna [38]

nr.	Organizata		Buxheti
1	Gllogoc		23,734,533
2	Fushë Kosovë		26,803,585
3	Lipjan		27,764,460
4	Obiliq		16,281,831
5	Podujevë		34,778,954
6	Prishtinë	(klauzola (1,953,100)	151,533,448
7	Shtime		11,443,985
8	Graçanicë		12,530,650
9	Dragash*		13,254,882
10	Prizren	(klauzola 1,400,000)	75,045,313
11	Rahovec		21,547,734
12	Suharekë		23,789,870
13	Malishevë		22,088,710
14	Mamushë*		3,522,136
15	Deçan*		14,551,974
16	Gjakovë		42,393,244
17	Istog		16,687,746
18	Klinë		16,338,898
19	Pejë		41,953,839
20	Junik*		2,538,612
21	Leposaviq		6,206,674
22	Mitrovicë		32,418,756
23	Skenderaj		20,245,396
24	Vushtrri		30,291,935
25	Zubin Potok		3,377,704
26	Zveçan		3,328,726
27	Mitrovica Veriore		6,715,284
28	Gjilan		41,928,925

29	Kaçanik	13,399,753
30	Kamenicë*	15,605,103
31	Novobërdë*	4,641,339
32	Shtërpcë*	7,671,260
33	Ferizaj	53,068,494
34	Viti	18,324,215
35	Partesh*	2,766,660
36	Hani i Elezit*	4,234,682
37	Kllokot	1,949,642
38	Ranillug*	2,708,166

**Institucionet lokale, 11 auditime të cilat do të përkrahen nga kompania private e auditimit.*

Auditime të pajtueshmërisë [10]*

**Temat për auditim të pajtueshmërisë, identifikohen gjatë procesit të auditimeve të rregullta.*

Auditime të pajtueshmërisë në proces [3]

1. Furnizimi me produkte për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë - SHSKUK (2024-2025)
2. Efiçienca e energjisë te ndërtesat publike - Komuna e Prishtinës
3. Menaxhimi i detyrimeve buxhetore që rezultojnë në vendime gjyqësore dhe përmbarimore (2024-2025)

Ndërmarrje publike [12]

Nr.	Organizata	Buxheti
1	Trepça SH.A.	559,729,179
2	KRM "Pastërtia" - Ferizaj	3,435,043
3	Korporata Energjetike e Kosovës SH.A.	277,248,066
4	Pasqyrat e veçanta të KEK-ut për nevoja të ZRRE-së	-
5	Pasqyrat e veçanta të KEK-ut për nevoja të KPMM	-
6	KRU "Prishtina" SH.A. -Prishtinë	84,352,199
7	KRM " Uniteti" SH. A. - Mitrovicë	2,316,386
8	NP KOSTT – SH.A.	140,311,118
9	NP "Termokos" SH.A.	77,926,038
10	NPH "Iber-Lepenci" SH.A. - Prishtinë	12,332,741

11	KRU “Hidro-Drini” SH.A. -Pejë	39,169,799
12	NPL “Stacioni i Autobusëve” SH.A. - Prishtinë	21,326,475

Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët [9]

Nr.	Organizata	Buxheti
1	Arsimi dhe Kujdesi për Fëmijët në Fëmijërinë e Hershme për Projektin e Kapitalit Njerëzor të Kosovës (MASH)	20,600,000
2	Forcimi i qeverisjes digjitale për ofrimin e shërbimeve (ASHI)	18,500,000
3	Projekti për përmirësimin dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes (MBPZHR)	9,150,000
4	Projekti për reformimin e sistemit të ndihmës sociale në Kosovë (MFPT)	47,000,000
5	Programi për nxitjen dhe shfrytëzimin e mundësive për sigurinë e ujit (MMPHI)	28,600,000
6	Projekti për infrastrukturën e pasurive të paluajtshme dhe infrastrukturën gjeohapësinore (Agjencia Kadastrale e Kosovës)	14,600,000
7	KOMPAS – qasje gjithëpërfshirëse për forcimin e sistemit shëndetësor në Kosovë (MSH)	18,600,000
8	Lehtësimi i tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0 (MFPT)	34,700,000
9	Zhvillimi i sektorit financiar të Kosovës (MFPT - BQK)	49,300,000

B. AUDITIMET E PERFORMANCËS

Tema të auditimeve të performancës[6] [18]

Nr.	Auditime të Performancës
1	Efikasiteti dhe efektiviteti i ofrimit të shërbimeve të transportit publik nga Trafiku Urban (*)
2	Ndërtimet e larta në Komunën e Prizrenit (*)
3	Efektiviteti i planifikimit, monitorimit të programeve të mbështetjes për bujqësi dhe zhvillim rural
4	Trajtimi i pacientëve në Klinikën Onkologjike
5	Tema e re (*)
6	Efektiviteti i furnizimit me ujë të pijshëm SDG 6
7	Menaxhimi i shërbimeve për mirëmbajtje/pastrim të objekteve publike (*)
8	Kontrolli i cilësisë së produkteve ushqimore të qumështit dhe vezëve (*)
9	Stadiumi "Rexhep Rexhepi"
10	Temë e re (*) - Auditim i shpejtë
11	Agjenda e reformave (*)
12	Inspektimi për garantimin e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat (*)
13	Legalizimi i objekteve pa leje në Komunën e Prishtinës
14	Efektiviteti i zbatimit të projektit të Autostradës Prishtinë–Gjilan në sigurimin e vlerës për para
15	Moduli i Rekrutimit në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
16	Sistemi/Moduli për Menaxhimin e Lëndëve në OSHP
17	Platforma e Cilësisë së Shërbimeve dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve nga ARKEP
18	Operimi i sistemeve të TI-së në Kuvendin e Kosovës

** Temat të cilat do të vazhdojnë edhe pas sezonit aktual të auditimit*

6 Temat e auditimit të performancës mund të rishikohen dhe të ndryshohen gjatë sezonit auditues, nëse paraqiten informata të reja ose rrethana që arsyetojnë ndryshimin e prioriteteve. Çdo ndryshim duhet të mbështetet në vlerësimin e rrezikut, rëndësinë dhe ndikimin e mundshëm të temës, si dhe në mundësinë që auditimi të sjellë përmirësime në menaxhimin e financave publike. Kjo qasje është në përputhje me parimet e përcaktuara në SNISA 100 – Parimet Themelore të Auditimit të Sektorit Publik dhe SNISA 300 – Parimet e Auditimit të Performancës.

Tema të auditimeve të performancës në proces [8]

Nr.	Auditime të Performancës në proces
1	Auditim Përcjellës (Follow-up) për raportet e publikuara të performancës për vitin 2020
2	Mbjellje të fidanëve nëpër komuna dhe taksa ekologjike
3	Furnizimi me barna për shëndetësinë primare dhe sëmundjet e rralla
4	Përcjellja e rekomandimeve - Lëndët Civile në Gjykata Themelore
5	Banimi i Përballueshëm dhe Social në komunën e Pejës, Gjilanit, Podujevës dhe Istogut
6	Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit
7	Sistemi Barnatari
8	Regjistri i bizneseve të Kosovës

PLANI VJETOR I AUDITIMIT
2026/2027



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës